

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË " BeeSolutions " SHPK**

Sot më datë 25.06.2022 palët e mëposhtme:

- Z. Gesi Kadiu, i biri i Përpërim Kadiu, i datëlindjes 23.09.1996 lindur në Tiranë, dhe banues në Tiranë, dhe
- Z. Erion Laci, i biri i Hasan Laci, i datëlindjes 09.06.1992 lindur në Lope, Kosovë, dhe banues në Reading, Angli, dhe
- Z. Evis Bakiu, i biri i Hekuran Bakiu, i datëlindjes 06.03.1986 lindur në Çarrovë, Skopje, dhe banues në Wolfrothhausen Gjermani dhe
- Znj. Elsa Bakiu, e bija e Hekuran Bakiu e datëlindjes 10.05.1988 lindur në Çarrovë, Skopje, dhe banues në Mynih, Gjermani.

shprehin vullnetin e tyre për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "Bee Solutions" sh.p.k. si më poshtë vijon:

**1. Forma ligjore e shoqërisë**

Shoqëria "Bee Solutions" Shpk, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht SHPK.

**2. Ortakët themelues**

Shoqëria është themeluar nga Ortakët e mëposhtëm:

- Z. Gesi Kadiu
- Z. Erion Laci
- Z. Evis Bakiu
- Znj. Elsa Bakiu

**3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "Bee Solutions" sh.p.k. do të jetë:

- Aktivitete të programimit informatik - Y6201
- Aktivitete të menaxhimit të instalimeve informatike - Y6203
- Aktivitete të hëshillimeve informatike - Y6202
- Shërbime të tjera të teknologjisë së informacionit - Y6209
- Çdo lloj veprimtarie të ligjshme që konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë.

#### 4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë “Bee Solutions” sh.p.k. do të jetë në Tiranë, në adresën:  
Rruga e Kavajës Nr. 50 ZK 8210, Nr Pasurie 5/374, Tiranë  
Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

#### 5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

#### 6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Bee Solutions” sh.p.k. është 4000 Lekë.

Ë gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortakët themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të **Asamblesë së Ortakëve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

#### 7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “Bee Solutions” sh.p.k. është Z. Gesi Kadiu.

Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “Bee Solutions” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kulijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

### Ortakët

Gesi Kadiu   
Erton Laci 

Evis Baku EB  
Elsa Baku 